



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi

Datë: 12.11.2018

Numri i seancës për këtë çështje: në proces

Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut"- projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).

A. Informacioni bazë

Institucioni dhe tema:	<i>Institucioni: Kolegji I Posacëm I Apelimit (këtu e më poshtë KPA). Objekti: Shqyrtimi I ankimit të paraqitur nga Komisioneri Publik, kundër vendimit nr. 22, dt. 07.06.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Edmond Islamaj.</i>
Emri i subjektit të rivlerësimit	<i>z. Edmond Islamaj.</i>
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	<i>Gjyqtar në Gjykatën e Lartë.</i>
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	<i>Seanca dëgjimore publike, u zhvillua në intervalin kohor 10:03-13:42, dhe u shty për në dt. 16 nëntor (4 ditë pas zhvillimit të seancës dëgjimore). Shtyrja e seancës është objektivist e arsyeshme për shkak të specifikës së çështjes, faktit që shqyrtohet në instancën e fundit ankimore vendimi i formës së prerë të së cilës krijon res judicata, kompleksitetit të çështjes, numrit të lartë të akteve provuese të kërkuara për administrim nën efektin e provës nga të dyja palët, si edhe pretendimeve të shumta paraqitur nga Komisioneri publik për riadministrim të provave administruar jo saktësisht nga KPK dhe administrim të akteve provuese të pamarra parasysh nga KPK.</i>
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmbledhur)	<i>Vendimi nuk u shpall në seancën publike të dt. 12 nëntor. Seanca u shty në dt. 16 nëntor ora 09:30, me qëllim për ti dhënë mundësi palëve të përgatisin parashtrimet përfundimtare duke studiuar aktet provuese që u administruan nga të dyja palët (subjekt I rivlerësimit-komisioneri publik) në seancën e sotme.</i>

B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca

Tupa gjykyese (emrat)	<i>Luan Daci - Kryesues I trupit gjykues; Sokol Como - Relator i çështjes; Albana Shtylla, Ina Rama dhe Rezarta Schuets - anëtarë të trupit gjykues; prezent pa shkëputje deri në përfundim të seancës dëgjimore.</i>
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	<i>Në cilësinë e vëzhguesit ndërkombëtar u paraqit z. Ferdinando Buatier de Mongeot; prezent pa shkëputje deri në përfundim të seancës dëgjimore.</i>
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	<i>Mbrojtja u realizua personalisht nga subjekti I rivlerësimit.</i>
Pala ankimuese (Komisionerët Publik/Subjekti I rivlerësimit) (gjeneralitetet)	<i>Komisionerët Publik: z. Florjan Ballhysa dhe z. Darjel Sina</i>

Monitoruesi/ja i/e KSHH:	Albana Misja	
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	Numri I anëtarëve nga publiku u konstatua të jetë gjithëpërfshirëse, me rreth rreth 25 persona, përfaqësues të institucioneve publike të interesuara, të shoqërisë civile, Avokatit të Popullit, dhe stafit të këshilltarëve ekonomik dhe ligjor të KPA dhe Komisionerëve Publik, me akses të plotë në hyrjen e godinës dhe pjesëmarrje fizike në	
Media e pranishme:	Mediat lokale ishin të pranishme, me përafërsisht 8 përfaqësues, me akses të plotë në hyrjen e godinës. Megjithatë pjesëmarrja e tyre u lejua vetëm në fazën përgatitore të seancës dëgjimore, pas së cilës i'u komunikua nga kryetari i trupit gjykues, të largohen nga salla së bashku me mjetet e regjistrimit, referuar Rregullores "Për marrëdhëniet me median".	
C. Përse është ushtruar e drejta e ankimit dhe cilat ishin argumentat/prapësimet e palës tjetër	Argumentat kryesore e subjektit që ka ushtruar të drejtën e ankimit	Prapësimet e palës tjetër
	<p>Pala ankuese (Institucioni i Komisionerit Publik) referoi se janë konstatuar mangësi në gjëndjen që janë aktet, dhe një hetim administrativ jo të plotë sa i takon vlerësimin të pasurisë të subjektit të rivlerësimit. Shkaqet e kryesore të ankimit të relatuar nga Komisionerët Publik, lidhen me vlerësimin e kriterit të pasurisë, përkatësisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Pasuri e paluajtshme, e llojit "kullotë": origjina e pretenduar: Kontrate Shitje me vlerë rreth 137 mije leke. Burimi i të ardhurave-paga. Çmimi referuar është më i ulët se çmimi i referencës përcaktuar nga VKM 514/2014. Sistem i shit-blerjes fasadë, duke ulur 20 fish vlerën e pasurisë. Kërkohet: hetim i plotë mbi origjinën e pronës. 2. Bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit ka tituj pronësie mbi 3 pasuri të paluajtshme, përfituar me k. shitje, të cilat janë të padeklaruar, përveçse në Formularin e Deklarimit të Pasurisë (Vetting) të 2017. Këto pasuri i kanë kaluar me k. Dhurimi subjektit të rivlerësimit. 3. Të ardhura të pamjaftueshme të bashkëjetueses për të vërtetuar aftësinë blerëse. 4. Ka pasaktësi nga të dhënat e ZRPP Durrës. Kërkohet: Të verifikohen: titullari i regjistrimit, koha e regjistrimit, rivlerësimi tatimor, titullari i shlyerjes së detyrimeve. 5. Bashkëjetuesja ka në posedim 2 garsonere përfituar me k. huapërdorje, të padeklaruar në vitin 2010. 6. Automjet, në vlerën 21 mije Euro, blerë pa kontratë, por vetëm me faturë tatimore. Kërkohet: të vërtetohet pagimi i çmimit. 7. Pasuri e paluajtshme. Titullar pronësie: femijet minorenë të subjektit të rivlerësimit. Origjina e fitimit: dhurim nga gjyshërit e subjektit. Akti pronësisë daton më vonë se formulari i pasurisë së Vettingut. 8. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare deklaroi sigurimi të një automjeti nën emrin e subjektit të rivlerësimit, si mjet në posedim i padeklaruar. Kërkohet hetim për vlerën e automjetit dhe marrëdhënien ligjore të subjektit të rivlerësimit dhe pronarit të automjetit (SHPK). 9. Dy automjete të shitura nga subjekti i rivlerësimit (marrëdhënie bashkëpronësie), kontratat e shitblerjes të së cilave nuk janë administruar nga KPK. 10. Kursimet vjetore të subjektit nuk përputhen me ato të deklaruara në Formularin e Pasurisë së Vettingut (mospërputhje në vlerën mbi 5 milion leke). 11. Sistemi TIMS ka regjistruar mbi 60 udhetime jashtë shtetit. Kërkohet: të vërtetohet mbulimi i shpenzimeve të bëra, dhe të administrohen adresat e qëndrimit. 12. Kërkohet: Të vërtetohet origjina e të ardhura të tjera të depozitave bankare, në pronësi të të atit të subjektit, në silësinë e personit tjetër të lidhur, sipas ligjit. 	<p>Subjekti i rivlerësimit paraqiti prapësimet e tij duke e cilësuar vendimin e KPK të drejtë, dhe duke kërkuar përfundimisht "lënie në fuqi të vendimit të KPK, që ka vendosur konfirmimin e tij në detyrë". Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti apel kundërshtues. Prapësimet paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, kundër shkaqeve të ankimit të parashtuara nga Komisionerët Publik, lidhur me vlerësimin e pasurisë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Pasuri e paluajtshme, e llojit "kullotë": blerë nga kursimet e pagave ndër vite, përfituar nga shitësi A.H, në 2010. Çmimi është përcaktuar me vullnet të pavesuar të palëve. Çmimi ka qenë i ulët për shkak të mungesës së energjisë elektrike dhe ka destinacion jo të qartë investimi. Pretendon se çmimi i referencës nuk është detyrues, por prevalon liria kontraktore. 2. Burimi i të ardhurave të bashkëjetueses së tij, i referohen marrëdhënieve të mëprashme të punësimit pranë OJF, dhe aktivitetit si përkthyes. Referon se fakti që nuk i janë paguar detyrimet tatimore nga punëdhënësi, nuk i bën të paligjshme të ardhurat e fituara nëpërmjet saj. Referon tek koncepti i bashkëjetesës në Kodin e Familjes, ku pasuritë i nënshtrohet administrimit të pasurive të ndara 3. Dy garsoneret në përdorim të bashkëjetueses i janë dhuruar nga i ati i saj 4. Pagesat e bëra për llogari të automjeteve janë kryer dorazi (cash), për efekt neglizhence 5. Të ardhurat e të atit të subjektit janë përfituar nga aktivitetet profesional ushtruar ndër vite si avokat, ekspert kriminalistike dhe më pas noter 6. Dhurimi nga i ati fëmijëve të tij të pasurive të paluajtshme, është kryer për efekt të gjëndjes së rëndë të tyre shëndetësore 7. Mënyra e pagesës së një automjeti vërtetohet me faturë tatimore, që sipas tij është e barabartë për efektet juridike që sjell me kontratën e shitjes 8. Pagesa e automjetit në vlerën 21 mijë euro, është bërë dorazi, për efekt të marrëdhënies miqësore me blerësin. Legjislacioni i kohës uk e pengonte këtë mënyrë pagimi, meqë palët janë persona fizik 9. Posedi i automjetit me policë sigurimi, nuk imponon marrëdhënien e posedimit, pasi automjeti është përdorur në periudha të shkurtra e jo të vazhdueshme.

C.1 Qëndrimi i vëzhguesve të ONM-së në proces	Përfaqësuesi i ONM-së konfirmon se nuk ka pyetje/komente
C.2 A u diskutuan/relatuan gjatë seancës ankesa nga publiku?	Jo
E.Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN, si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)	<p>Akresi i pjesëmarrjes, nga publiku, shoqëria civile, institucionet e tjera të interesuara dhe mediat lokale është respektuar. Megjithatë, është krijuar praktikë procedurale urdhërimi i medias për të lënë sallën së bashku me pasjiset e regjistrimit, pas fazës përgatitore. Etika e sjelljes së trupit gjykues është e rregullt dhe të folurit të kuptueshëm. Kohëzgjatja e seancës publike prej më tepër se 4 orë, justifikoj ndërprerjen e seancës për një pushim prej 60 minutash, kohë në të cilën trupi gjykues u tërhoq për marrjen e vendimit. Elementet procedural të procesit gjyqësor, referuar nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, janë respektuar. Kryetari i trupit gjykues parashtron procedurën e seancës dëgjimore. I jepet e drejta procedurale subjektit të rivlerësimit për të kundërshtuar pretendimet e Komisionerëve Publik. Njoftohet dhe pranohet në seancë, se ka marrë djeni lidhur me vendimin dhe shkaqet e ankimit. I rezervohet e drejta e pyetjes vëzhguesit ndërkombëtar dhe trupës gjykuese. Seanca pati një kohëzgjatje të arsyeshme prej rreth 5 orësh, duke marrë parasysh volumin e akteve provuese të paraqitura dhe pretendim/prapësimeve të palëve. Seanca shtyhet për ditën e premtë, me qëllim mbrojtjen e qëndrimeve ligjore të palëve dhe njohjes me aktet provuese paraqitur nga subjekti i rivlerësimit.</p>